



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Doretuar Punje/Prodato Received/Delivery | 30.06.2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SADVSHUK | 4991/2023 | | 116 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.712/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.712/2023 të datës 24.04.2023 të parashtruar nga ankuesit:

autorizimit i përfaqëson nëpunësi kundër organit të punësimit të cilët sipas Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike „kompensim material“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.06.2023 mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.712/2023 e datës 05.05.2023, e parashtruar nga ankuesit

Ar sy e t i m

Ankuesit

dhe (tutje vetëm ankuesit), me datën 05.05.2023 përmes përfaqësuesit me autorizim kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të mos ekzekutimit të pagesave për shujtën ditore, me pretendimet ankimore se baza ligjore për të drejtën e shujtës ditore është përcaktuar me nenin 29 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, të njëjtit kërkojnë aprovimin e së drejtës për kompensim të shujtës ditore si dhe kompensimin në mënyre retroaktive edhe për muajt e pa realizuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 15.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokollit 4742/2023 të datës 14.06.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4078/2023 e datës 05.05.2023 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 14.03.2023 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të SHKK-së; Shkresën zyrtare lidhur me pagesën e shujtës për ditët e muajit shkurt dhe mars në muajin prill; Autorizimin me Nr.115 të datës 12.05.2023 nga përfaqësuesi i ankuesve së bashku me listën e emrave të ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.05.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; E-mailin zyrtar të datës 14.03.2023 nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të SHKK-së për nëpunësin në Thesarin e Kosovës; Vendimin me Nr.648 të datës 30.08.2022 të zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Listën e pagave për muajin shkurt të vitit 2023 lidhur me dëshminë për pagesën e shujtës; Listën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 lidhur me dëshmitë për pagesën e shujtës për ankuesit sipas ankesës së bashkangjitur; Listën e pagave për muajin nëntor të vitit 2022 lidhur me dëshmitë për pagesën e shujtës për ankuesit sipas ankesës së bashkangjitur; Listën e pagave për muajin tetor të vitit 2022 lidhur me dëshmitë për pagesën e shujtës për ankuesit sipas ankesës së bashkangjitur; Listën e pagave për muajin prill të vitit 2023 lidhur me dëshmitë për mos pagesën e shujtës për ankuesit sipas ankesës së

bashkangjitur; Listën e pagave për muajin mars të vitit 2023 lidhur me dëshmitë për mos pagesën e shujtës për ankuesit sipas ankesës së bashkangjitur; Akt emërimin e datës 05.03.2012 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2014; Akt emërimin e datës 01.08.2016 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2019; Akt emërimin e datës 07.05.2012 për ankuesen Akt emërimin me numër AE.Nr.106/2023 te datës 24.01.2023 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2019; Akt emërimin me numër AE.Nr.105/2023 te datës 24.01.2023 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2019; Akt emërimin e datës 07.06.2019 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 13.03.2014; Akt emërimin e datës 07.06.2019 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.02.2019; Akt emërimin e datës 05.03.2013 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2014; Akt emërimin e datës 20.11.2018 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 04.06.2008; Akt emërimin e datës 02.05.2012 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.10.2014; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimin te datës 04.09.2017 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2014; Akt emërimin e datës 20.11.2018 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2014; Akt emërimin e datës 03.09.2012 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 15.06.2012; Akt emërimin e datës 31.07.2012 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 14.05.2007; Akt emërimin e datës 05.03.2013 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 14.05.2007; Akt emërimin e datës 01.09.2016 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 16.05.2007; Akt emërimin e datës 13.03.2019 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2019; Akt emërimin e datës 05.03.2013 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2019; Akt emërimin e datës 02.10.2012 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës të datës 25.07.2012; Akt emërimin e datës 06.05.2019 për ankuesin Akt emërimin e datës 05.03.2013 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimin e datës 11.03.2013 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 16.05.2007; Akt emërimin e datës 05.03.2012 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 01.08.2014; Akt emërimin e datës 05.03.2013 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 19.10.2006; Akt emërimin e datës 04.01.2013 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës te datës 11.10.2012; Akt emërimin e datës 05.03.2013 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimin me numër AE.Nr.003/2022 te datës 24.02.2022 për ankuesen bashku me dëshminë mbi konkursin e datës 07.12.2021 sipas numrit te referencës RN00007915 në Ministrinë e Drejtësisë; Vendimin me Nr.113/2023 te datës 28.04.2023 lidhur me caktimin e nëpunësit ne pozitën e Drejtorit te Përgjithshëm te SHKK-së se bashku me përshkrimin e detyrave te punës; Vendimin Nr.112/2023 te datës 28.04.2023 lidhur me

caktimin e nëpunësit ne pozitën e Zëvendës Drejtorit te Përgjithshëm për Trajtim te Burgosurve, Financa dhe Shërbime te Përgjithshme të SHKK-së se bashku me përshkrimin e detyrave te punës; Vendimin Nr.29/2023 te datës 31.01.2023 lidhur me caktimin e nëpunësit ne pozitën si Zëvendësues i Drejtorit te Përgjithshëm për Siguri dhe Operative ne SHKK se bashku me përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit e datës 05.03.2013 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit me numër AE.Nr.004/2022 te datës 28.02.2022 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit e datës 10.03.2017 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit te datës 07.05.2019 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit e datës 16.11.2018 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit e datës 11.04.2017 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi kopjen e konkursit me Nr.17 te datës 21.02.2017 ne SHKK për pozitën si Udhëheqës i Njësisë për Pranimin e mallit ne Prishtine; Akt emërimit e datës 16.11.2018 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit me numër AE.Nr.120/2023 te datës 24.03.2023 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit te datës 27.02.2015 për ankuesin se bashku me përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit me numër AE.Nr.064/2022 te datës 01.07.2022 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit e datës 05.03.2013 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit e dates 28.09.2015 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit me numër AE.Nr.114/2023 te datës 27.02.2023 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit e datës 23.07.2012 për ankuesen se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Akt emërimit me numër AE.Nr.074/2022 te datës 01.12.2022 për ankuesin se bashku me dëshminë mbi përshkrimin e detyrave te punës; Vendimin e datës 20.04.2023 lidhur me caktimin e ankueses ne pozitën si Zyrtare e larte për trajtimin e te burgosurve, te miturve si dhe çështjes sociale ne Drejtorinë e Përgjithshme te SHKK-së se bashku me përshkrimin e detyrave te punës se ankueses; Vendimin e datës 08.02.2023 me Nr.162 lidhur me caktimin e ankueses me detyra te punës ne Gjykatën Themelore ne Prishtine dhe Vendimin e datës 20.10.2022 me Nr.1075 lidhur me caktimin e ankueses ne pozitën si Zyrtare Kontaktuese ndërlidhës mes Shërbimit Korrektues dhe Policisë se Kosovës, si dhe Vendimin me numër protokolli 4742/2023 te datës 14.06.2023 të Këshillit lidhur me vazhdimin e afatit te ankesës se ankuesve.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së pretendimet ankimore të ankueseve janë të *pabazuara, sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi janë të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datë 14.03.2023 ka proceduar kërkesën për shujtë ditore për personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës (*tutje vetëm SHKK*) në Thesarin e Kosovës, ndërsa ky i fundit me datë 14.03.2023 ka njoftuar SHKK-

në me tekstin "....se sipas ligjit të ri të pagave dhe rregulloreve të miratuara kompensimi për shujtë ditore nuk parashihet dhe se nga muaji i ardhshëm këto pagesa nuk mund të procesohen".

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore për kompensimin e shujtës ditore Kolegji i Këshillit, ka analizuar bazën mbi të cilën është parashtruar ankesa përkatësisht dispozitat e nenit 29 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës i zbatueshëm nga data 23.08.2022 me të cilat është përcaktuar se: "1. Përveç të Drejtave që janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit të Punës, personeli i SHKK-së ka edhe këto të drejta dhe detyrime specifike: 1.1. e drejta e shtesës së rrezikshmërisë mbi pagë: 1.1.1. personeli i SHKK-së për shkak të ekspozimit ndaj rrezikut të lartë dhe të drejtpërdrejt me të burgosur me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë, dënim dhe dënim të përgjithshëm, sëmundje infektive çrregullime mendore, ekspozimit rrezikut gjatë përcjelljes së të burgosurit jashtë institucionit korrektues, gëzon shtesë mbi page për rrezikshmëri në punë;. kategorizimi i personelit të SHKK-së që përfiton shtesë mbi pagë për rrezikshmëri do të rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri i Drejtësisë. 1.2. e drejta e pagës jubilarë: 1.2.1. personeli i SHKK-së gëzon të drejtën e një page jubilarë për çdo dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprerë në vlerë të një page bazë. 1.3. e drejta në shtesë të një page bazë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes; 1.4. e drejta e një shujte ditore: 1.4.1. personeli i SHKK-së gjatë kryerjes së detyrës zyrtare e gëzon të drejtën e një shujte ditore; 1.4.2. vlera e shujtës ditore përcaktohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm. 1.5. e drejta në kompensim për vdekje në detyrë apo në kryerje të detyrës. 1.5.1. SHKK paguan shpenzimet e ceremonisë së varrimit për personelin e SHKK-së që vdesë gjatë kryerjes së detyrës apo që ndërlihet me detyrën zyrtare. Vendvarrimi do të caktohet nga anëtarët e familjes".

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (i zbatueshëm nga data 05.02.2023), konkretisht me nenin 45 është shfuqizuar çdo dispozitë ligjore e është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji e që i referohen çështjes së pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik janë shfuqizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës të cilat rregullojnë çështjen e pagave dhe kompensimeve të personelit korrektues dhe si të tilla janë të pa zbatueshme.


Ndërlidhur me konstatimin si me sipër Kolegji i'u referuar edhe nenit 1 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik me të cilin është përcaktuar se: **Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë,** si dhe nenit 2 të të njëjtit ligj i cili parasheh se: "Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë, andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor Kolegji i Këshillit vlerëson se Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka vendosur rregulla unike lidhur me pagat dhe kompensimet për të gjithë të punësuarit në sektorin publik (përjashtimisht institucionit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës), duke u bazuar në parimet e ligjshmërisë, barazisë, dhe mos diskriminimit si dhe transparencës, kështu që çdo

realizim i pagave dhe kompensimeve jashtë rregullimit ligjor të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik bie ndesh me dispozita ligjore të të njëjtit ligj, kështu që mbi këtë bazë Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesve për kompensim të shujtës ditore janë të pa bazuar dhe si të tilla nuk kanë mbështetje ligjore.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.712/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit


Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesve
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.